

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga Frosina Sylejmani, kryetare e kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Isa Shala anëtar, në çështjen juridike – kontestimore të paditësve SH.SH. dhe M.SH. nga Kaçaniku, të cilët me autorizim i përfaqëson A.I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “T” të cilën me autorizim e përfaqëson A.H.- K. avokate nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.211/12 të datës 19.02.2014, me datë 10.10.2017 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të paditurës Kompania e Sigurimeve “T”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.211/12 i datës 19.02.2014, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar C.nr.211/12 të datës 19.02.2014, gjykata e shkallës së parë, në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve SH.SH. dhe M.SH. nga Kaçaniku dhe e ka detyruar të paditurën, Kompania e Sigurimeve “T”, me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompenzimit të dëmit jo material dhe material, të pësuar në aksidentin e komunikacionit i cili ka ndodhur me datë 14.07.2012, t’ia paguaj shumat si në pikën 1/a të dispozitivit, që paditësit SH.SH., në emër të dëmit jo material: për dhimbje fizike trupore t’ia paguaj shumën prej 1300,00 Euro, për frikën e shkaktuar shumën prej 1000,00 Euro, për shëmtim trupor shumën prej 1300,00 Euro dhe në emër të dëmit material t’ia paguaj shumat në vijim: në emër të dëmëve të pësuar në automjet shumën prej 1700,00 Euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 50,00 Euro, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 200,00 euro, gjithësej shumën prej 5550,00 Euro, pastaj në pikën 1/b të dispozitivit gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurën që paditëses M.SH. në emër të dëmit jo material t’ia paguaj shumat si në vijim, për dhimbje fizike trupore shumën prej 2400,00 Euro, për frikën e shkaktuar shumën prej 600,00 Euro, për shëmtim trupor shumën prej 1200,00 Euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 2400,00 Euro, në emër të dëmit material: për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumën prej 200,00 Euro, për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 170,00 Euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 100,00 Euro, për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 124,00 Euro, gjithësej shumën prej 8194,00 Euro, gjithësej për pikat 1/a dhe 1/b shumën prej

13.744,00Euro, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar mbi një vit, duke filluar nga data 03.12.2013 e gjerë në pagesën definitive, në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara dhe atë për 2800,00 Euro, në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar e paditura që paditësve shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.329 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i të paditurës, av. A.H.- K. nga Prishtina, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe lartësisë së kërkesëpadisë, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.211/12 të datës 19.02.2014, ta prishë dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit SH.SH. dhe M.SH. nga Kaçaniku me datë 17.12.2012 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “I” me seli në Prishtinë, të precizuar me anë të parashtrësës të datës 13.01.2014 me te cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “I” në Prishtinë, që paditësve në emër të dëmit jo material dhe material si pasojë e aksidentit të datës 14.07.2012 t’ia kompenzoj shumat dhe atë 1. Paditësit SH.SH., për demin jo material shumat në vijim: për dhimbje fizike shumën prej 1.500,00 Euro, për frikën e përjetuar shumën prej 1.500 Euro, për shëmtim trupor shumën prej 1.500,00 Euro, dhe në emër të dëmit material t’ia kompenzoj shumat në vijim: për demin e pësuar në automjet shumën prej 1.700,00 Euro, ndihmë dhe përkujdesjen e huaj shumën prej 200,00 Euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 50,00 Euro, gjithsej shumën prej 6.450 Euro, ndërsa për paditësen 2. M.SH. t’iu kompenzohen shumat në vijim, në emër të dëmit jomaterial: për dhimbjet fizike shumën prej 3.000,00 Euro, për frikën e përjetuar shumën prej 2.000,00 Euro, për shëmtim trupor shumën prej 1.500,00 Euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 3.000,00 Euro, për demin material: në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së huaj shumën prej 200,00 Euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 100,00 Euro, për rehabilitim fizioterapeutik klimatik shumën prej 170,00 Euro, për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 124,00 Euro, gjithsej shumën prej 10.094,00 Euro, gjithsej për pikat 1 dhe 2 shumën prej 16.544,00 Euro, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat për mjetet e afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data e aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës

kontestimore në shumën prej 1.329,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Në arsyetimin e Aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me datë 14.07.2012 në vendin e quajtur Fusha e Pajimit - Kaçanik i vjetër është shkaktuar aksidenti i komunikacionit kur ngasësi i automjetit Volkswagen 253, me ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit..., i cili qarkullonte nga Kaçaniku i vjetër në drejtim të Shtërpçës, e kur arrinë në vendin e quajtur ... tenton të hyjë nën urën magjistrale Ferizaj-Kaçanik për të dalur në rrugë në drejtim të Shtërpçës, ku nga pakujdesia dhe duke mos respektuar shenjë të komunikacionit STOP dhe përparësisë së kalimit si dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, me pjesën e përparmë të automjetit e godet me pjesën e përparme të automjetit të udhëtarëve Toyota Carina me targa .... të cilin në drejtimin nga Shtërpca në drejtim të Ferizajit e voziste paditësi SH.SH., nga kjo goditje përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson vozitësi SH.SH. dhe ndërsa lëndime të rënda trupore pëson bashkudhëtarja M.SH..

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e njëjta gjatë shqyrtimit kryesorë nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

Ndërsa për natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi dhe vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë ekspertizat mjekësore të përpiluara nga ekspertë mjekësorë nga lëmia e ortopedisë –traumatologjisë dr. V.B.1. dhe nga lëmia e psikiatrisë dr. V.B.2., mendime këto të dhëna në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 03.12.2013, pas ekzaminimit direkt të palës së dëmtuar dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor.

Nga mendimi i përbashkët i eksperteve mjekësorë është konstatuar se paditësi SH.SH. në aksidentin e datës 14.07.2012 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës, plagë shqyese në mbivetullën e djathtë e cila është qepur, ndrydhje të trupit, të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore, e si pasojë e të cilave paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditëve, të intensitetit të mesëm 3 javë, dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët 60 ditë, po ashtu paditësi SH.SH. ka pësuar frikë primare e cila ka zgjatur për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24 orë, si dhe frikë sekondare e intensitetit të mesëm dhe të ulët e cila ka zgjatur për 6 javë, po ashtu nga ekspertiza e ekspertit është konstatuar se paditësi ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së ulët për shkak të vragës së mbetur në mbivetullën e djathtë, gjithashtu kanë konstatuar se ka pas nevojë për ndihmë nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 8 ditësh si dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej dy javësh. Ndërsa paditësja M.SH. sipas ekspertëve mjekësorë, në aksidentin e komunikacionit ka pësuar këto lëndime trupore: thyerje të olekanit (bërrylit të djathtë), plagë shqyese në regjionin e djathtë të faqes, e cila është përpunuar, i cili lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, e si rezultat i këtij lëndimi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje

prej 60 minutave, të intensitetit të rëndë 2 ditë, të intensitetit të mesëm 3 javë, të intensitetit të ulët 2 muaj, sipas ekspertit nga lëmi i psikiatrisë vërtetohet se paditësja M.SH. në momentin e aksidentit ka pësuar frikë të primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, pastaj ka kaluar në frikë të intensitetit të mesëm dhe të ulët që ka zgjatur 8 javë. Nga mendimi i ekspertes së ortopedisë po ashtu është vërtetuar se tek paditësja ekziston shkalla e ulët e shëmtimit për shkak të vrazës së mbetur pas qepjes në faqen e djathtë, gjithashtu zvogëlimi i aktivitetit jetësor në shkallë prej 10% për shkak të bërrylit të dorës së djathtë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (b),(g),(j),(k) dhe (m) të LPK-së, e të cilat i vlerëson sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është mjaft i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të çështjes për provat e administruar në lidhje me vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e gjykatës në lidhje me mënyrën se si i ka vërtetuar faktet.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes përveç atyre që kanë qenë jo kontestuese janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Në mënyrë specifike për këtë bazë e paditura i është referuar vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike sa i përket kundërshtimeve në lidhje me moshën e të paditurve, të cilët sipas të paditurës dëmi jo material caktohet në bazë të moshës, të cilin pretendim ankimor Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar si të themeltë sepse duke marrë në konsideratë ekspertizën e ekspertëve nga lëmi i mjekësisë, Gjykata e Apelit vlerëson se është krijuar baza që paditësve t'i pranohen kompensimi për dëmin material dhe jo material, ndërsa sa i përket lartësisë është pranuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, pasi që shuma e gjykuar është në përputhje me dëmin e shkaktuar.

Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vërtetimit të lartësisë së kompensimit në të holla për të gjitha aspektet e dëmit jo material ka vlerësuar intensitetin e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar në atë mënyrë që, ka pasur parasysh rëndësinë e të mirës së shkelur dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi, për arsye se kompensimi i dëmit jo material dhe material është lloj i vënies së baraspeshës në mes të kompensimit në të holla të gjykuar me të mirat e shkelura të paditësve, në mënyrë që të vihet ekuilibri në mes të lartësisë së kompensimit në të holla me të mirat respektivisht lëndimet e shkaktuara.

Gjykata e shkallës së dytë, pati parasysh edhe dispozitat e nenit 200 të LMD-së, duke pasur parasysh edhe rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit që i shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqërorë.

Nga arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195. par. 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1593/14 me datë 10.10.2017**

**Kryetare e Kolegjit**  
**Frosina Sylejmani**